



UNIVERSITETI I TIRANES
FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE



KONFERENCA KOMBËTARE MBROJTJA E FËMIJËVE NGA DHUNA NË SHQIPËRI



SHERBIMI LIGJOR FALAS TIRANE



KONFERENCA KOMBËTARE

MBROJTJA E FËMIJËVE NGA DHUNA NË SHQIPËRI

Tiranë, 22 dhjetor 2016

Hyrje

Dhuna ndaj fëmijëve është një ndër problemet më serioze që rrezikon zhvillimin e tyre, shëndetin dhe mirëqenien, të drejtat themelore, dinjitetin dhe jetën e fëmijëve. Shqipëria është një vend ku dukuria e dhunës ndaj fëmijëve është sa e përhapur, aq edhe e fshehtë. Përmes miratimit dhe zbatimit të ligjeve dhe politikave të reja gjendja e fëmijëve dhe adoleshentëve në Shqipëri është përmirësuar ndjeshëm, por ende shumë fëmijë dhe adoleshentë në të gjithë vendin rrezikohen nga varfëria dhe përjashtimi social.

Përpjekjet dhe nisma e Qeverisë shqiptare për të ngritur një sistem efektiv për mbrojtjen e fëmijëve, për të siguruar zbatimin e parimeve të bashkëpunimit ndërsektorial dhe forcimin e aftësisë së sistemit për të parandaluar, reaguar dhe mbrojtur fëmijët nga të gjitha format e dhunës, sjell në tryezë të gjithë aktorët për të diskutuar modele dhe praktika pozitive, por edhe sfidat që do t'i shërbejnë zbatimit të projektligjit "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, UNICEF dhe CRCA Shqipëri, në bashkëpunim me organizatat Terre des Hommes, World Vision, Save the Children, Partnerë për Fëmijët, ALO 116, QSHPLI, TLAS, Observatori për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri, Arsis, Fëmijët Sot, Shkej dhe në partneritet me Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, dhe Fakultetin e Shkencave Sociale, organizojnë Konferencën e 2-të Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna.

Kjo konferencë organizohet në kuadër të dy fushatave të rëndësishme të qeverisë shqiptare: Pakti i Mirëqënies Sociale dhe #UnëMbrojFëmijët. Gjithashtu ajo organizohet edhe në kuadër të programit të UNICEF "Mbrojtja e fëmijëve nga dhuna në Shqipëri", zbatuar nga Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, i cili ka për synim të forcojë partneritetin ndërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe vendim-marrësve shtetërore, me qëllim për të forcuar sistemin e politikave dhe shërbimeve publike në identifikimin, raportimin, dhe referimin e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve.

Objektivi kryesor

Objektivi kryesor i konferencës është nxitja e dialogut kundër abuzimit ndaj fëmijëve si dhe prezantimi i praktikave, tendencave, metodologjive dhe të dhënave të cilat do të ndihmojnë në identifikimin e mundësive dhe mangësive në këtë fushë. Ajo synon të diskutojë në lidhje me keqtrajtimin dhe abuzimin kundër fëmijëve dhe nevojës për programe efektive për parandalimin dhe përgjigjen ndaj këtij fenomeni. Ajo synon të mbledhë së bashku institucionet shtetërore dhe organizatat e shoqërisë civile për të nxitur një angazhim më aktiv për promovimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijës (neni 19 dhe 34 i Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës). Konferenca do të ofrojë rekomandime mbi mënyrën se si mund të përmirësohet parandalimi dhe reagimi ndaj abuzimit të fëmijëve.

Objektiva të tjera

- Të shërbejë si një forum për akademikët, politikanët dhe vendimmarrësit për të diskutuar mbi eksperiencat/modelet e reja ose metodologjitë për parandalimin dhe përgjigjen e dhunës ndaj fëmijëve;
- Të nxitë dokumentimin e praktikave premtuese dhe dialogun profesional ndërmjet akademikëve, medias, organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore, me fokus shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve në institucionet qendrore dhe vendore;
- Të diskutojë rolin dhe detyrimet e pushtetit vendor në kuadër të zhvillimeve të reja ligjore për mirëqenien sociale të fëmijëve;
- Të rritë sensibilizimin dhe ndjeshmërinë e opinionit publik, organizatave të shoqërisë civile, vendimmarrësve dhe hartuesve të politikave, akademikëve, komunitetit të gjerë se si të përqendrohen përpjekjet mbi parandalimin e dhunës ndaj fëmijëve përmes punës ndërsektoriale, përmirësimit të sistemit të mbrojtjes sociale dhe shërbimeve sociale.

Sesionet tematike

Organizimi i kësaj konference u bë në bashkëpunim me organizatat kryesore në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, si: Terre des Hommes, World Vision, Save the Children, Partnerë për Fëmijët, ALO 116, QSHPLI, TLAS, Observatori për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri, Koalicioni për Arsimin e Fëmijëve, Arsis, Fëmijët Sot dhe Shkej. Në këtë kuadër gjatë periudhës korrik-dhjetor 2016 janë zhvilluar takime konsultuese dhe janë ngritur grupe pune që mundësuan organizimin dhe ideimin kësaj konference. Grupet e punës, të ndara në katër sesione të posaçme, identifikuan, hartuan dhe lehtësuan përzgjedhjen e të gjithë

aktorëve të përfshirë në prezantim, moderim dhe raportim. Një grup i posaçëm u ngrit me përfaqësues të OSHC-ve të ndryshme për të garantuar pjesëmarrjen e fëmijëve në të gjithë procesin e planifikimit, organizimit dhe zhvillimit të Konferencës. Konferenca do të diskutojë 4 (katër) tema kryesore:

Sesioni 1: Roli i pushtetit vendor në ngritjen dhe fuqizimin e sistemit lokal të mbrojtjes së fëmijëve

Grupi i punës përbëhet nga: Shërbimi Social Shtetëror, Terre des Hommes, World Vision, Save the Children, Partnerë për Fëmijët, ASHMDF dhe Observatori për Mbrojtjen e Fëmijëve

Sesioni 2: Roli i institucioneve arsimore dhe komunitetit të shkollës në adresimin e dhunës në shkolla

Grupi i punës përbëhet nga: CRCA, QSHPLI, World Vision, Partnerë për Fëmijët, ALO 116, Fëmijët Sot, ASHMDF dhe Terre des Hommes

Sesioni 3: Shërbimet e specializuara për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe abuzimi

Grupi i punës përbëhet nga: ALO 116, Terre des Hommes, QSHPLI, TLAS, Arsis, Shkej, ASHMDF.

Sesioni 4: Dhuna ndaj fëmijëve dhe media

Grupi i punës përbëhet nga: Terre des Hommes, Save the Children, ALO 116, Observatori për të Drejtat e Fëmijëve, ASHMDF.

Tema Cross-cutting

- Masat e mbrojtjes ndaj fëmijëve (sipas projektligjit të ri)
- Pjesëmarrja e fëmijëve. **Grup pune: ALO 116, Terre des Hommes, Save the Children, World Vision**
- Mos-diskriminimi (mbrojtja e fëmijëve nga diskriminimi)
- Barazia gjinore

Rezultatet e pritshme

- Të paktën 20 ekspertë nga fusha të ndryshme prezantojnë modelet, iniciativat dhe eksperiencat e tyre në një nga fushat tematike lidhur me dhunën ndaj fëmijëve;
- Mundësimi i një platforme për një dialog publik ndërmjet parlamentarëve, institucioneve publike, OJF-ve dhe ekspertëve për të drejtat e fëmijës;
- Rekomandimi i nismave të reja ligjore dhe/ose modeleve të reja kundër dhunës ndaj fëmijëve;
- Sensibilizimi i publikut në nivel kombëtar mbi problemin e dhunës ndaj fëmijëve.

Pjesëmarrësit/grupet e synuara

Konferenca synon të mbledhë së bashku qeverinë, ligjvënësit, hartuesit e politikave, vendimmarrësit, zbatuesit e programeve, qeverinë vendore, shoqërinë civile dhe media. Konferenca do të sjellë të paktën 80 pjesëmarrës përgjatë një dite për të diskutuar dhe dhënë rekomandimet e tyre mbi katër fushat tematike.

Gjuha e konferencës do të jetë shqip. Gjatë seancës plenare të 1-rë do të ketë përkthim simultan shqip-anglisht.

AXHENDA (Draft)

22 dhjetor 2016, Tiranë

Vendi: Aula Magna, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës

09.00 - 09.30 **Regjistrimi i pjesëmarrësve**

SEANCË PLENARE I

09.30 – 10.30 **Mirëseardhja dhe Fjalët Përshëndetëse**

*Fjala e mirëseardhjes: Prof. Dr. **Edmond Rapti**, Dekan i Fakultetit të Shkencave Sociale, UT*

Moderatore: Znj. Ina Verzivolli, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve

- **Znj. Bardhylka Kospiri**, Zëvendësministre, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
- **Znj. Nora Malaj**, Zëvendësministre, Ministria e Arsimit dhe Sportit
- Përfaqësues i “Grupit Parlamentar “Miqtë e Fëmijëve”
- **Znj. Antonella Scolamiero**, Përfaqësuese e UNICEF
- **Z. Igli Totozani**, Avokati i Popullit
- **Znj. Irma Baraku**, Komisionere për Mbrojtjen nga Diskriminimi

10.30 - 10.45 **Pushim Kafeje & Sesionet e Posterave**

SESIONE TEMATIKE

SESIONI 1

10.45 – 12.30

Sesion Tematik I: Roli i pushtetit vendor në ngritjen dhe fuqizimin e sistemit lokal të mbrojtjes së fëmijëve.

Moderatore:

Znj. Merita Poni, Fakulteti i Shkencave Sociale

1. Ligji i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror: Rolet, funksionet dhe detyrimet për pushtetin vendor.

Znj. Denada Dibra, MMRS

2. P/Ligji për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve: Rolet, funksionet dhe detyrimet për pushtetin vendor.

Znj. Kleopatra Gjika, Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve

3. Mbrojtja e fëmijëve në kuadër të Planeve Lokale Sociale

Znj. Anisa Ruseti, Bashkia Tirane

4. Bashkia Shkodër: Shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe abuzimi: Sfidat dhe mundësitë për përmirësim

Z. Filip Vila, Bashkia Shkodër

**Pyetje, Përgjigje dhe Diskutime
Konkluzione**

SESIONI 2

10.45 – 12.30

Sesion Tematik II: Roli i institucioneve arsimore në adresimin e dhunës në shkolla

Moderatore:

Prof. Dr. Edlira Haxhiymeri, Fakulteti i Shkencave Sociale

1. Video ndërgjegjësuese: JO DHUNËS!

Znj. Anjeza Kaçorri, Gjimnazi “Petro Nini Luarasi”

2. Qasje dhe modele në adresimin institucional të dhunës në shkolla

Znj. Rozalba Merdani, MAS

3. Përvoja të disiplinimit pozitiv të fëmijëve në shkolla

Z. Pjetër Doda, Mësues, Programi COMBI, Shkolla 9-vjeçare “Nënë Tereza”, Rrëshen

4. Qasja “Hapi i Dytë”

Z. Besnik Kadesha, Save the Children

5. Histori të vogla: Dhuna në shkolla nga këndveshtrimi i fëmijëve

Bordi i Fëmijëve ALO 116 dhe grupi “Fëmijët dhe të Rinjtë në Kuvend”

**Pyetje dhe Përgjigje dhe Diskutime
Konkluzione**

12.30 – 13.00 PUSHIM DREKE – Bufë

SESIONE TEMATIKE

SESIONI 3

13.00 - 14.30

Sesion Tematik III: Shërbimet e specializuara për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe abuzimi

Moderatore:

Znj. Anila Sulstarova, Fakulteti i Shkencave Sociale

1. Modelet e shërbimeve të specializuara për fëmijët viktime të abuzimit seksual

Znj. Blerta Mane, Terre des Hommes

2. Profili i psikologut të specializuar:

Z. Florian Kulla, Psikolog për Fëmijët

3. Shërbimet e emergjencës për fëmijët: *Z. Zini Kore, ARSIS*

4. Këshillimi telefonik pranë ALO 116:

Znj. Erinda Ibrahimllari / Z. Mirgit Vataj, ALO 116 Shqipëri

5. Profesionistët ligjorë për fëmijët:

Znj. Anisa Metalla, TLAS

Z. Pëllumb Hyso, QSHPLI

**Pyetje, Përgjigje dhe Diskutime
Konkluzione**

SESIONI 4

13.00 - 14.30

Sesion Tematik IV: Dhuna ndaj fëmijëve dhe media

Moderatore:

Z. Belioza Çoku, ALO 116-111 Shqipëri

1. Përfaqësimi i gabuar i fëmijëve në media:

Znj. Anila Bregu, ASHMDF

2. “Portretizimi i fëmijëve në media”

Znj. Eridjona Kica, Observatori për të Drejtat e Fëmijëve

3. Funksionimi i mekanizmave ligjore, monitoruese dhe institucionale në transmetimet audio-vizive.

Znj. Monika Stafa, AMA

4. A zbatohen parimet etike të punës me fëmijët viktime të dhunës dhe abuzimit.

Z. Ben Andoni, Gazetar (Për t’u konfirmuar)

**Pyetje, Përgjigje dhe Diskutime
Konkluzione**

SESSION PLENAR II: KONKLuzionet e Konferencës

Moderatore: Znj.Ina Verzivoli, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve

14.30 – 15.00 Raportim nga grupet e punës mbi rekomandimet, konkluzionet dhe hapat për të ardhmen
Përfundimet e Konferencës dhe mbyllja e saj